# DOKUMENTE E MATERIALE

DHIMITËR S. SHUTERIQI

## FJALORTH I TË FOLMES SHQIPE TË FSHATIT MANDRICE (BULLGARI)

Ky Fjalorth i së folmes shqipe të Mandricës u hartua me fjalët dhe frazeologjinë që mblodhëm atje (nuk futëm këtu asgjë nga tekstet), gjatë bisedave të lira dhe në bazë të një kestionari të thjeshtë, që kërkonte, p.sh., emrat e bimëve, të zoqve, kafshëve, pjesëve të trupit të njeriut, veglave të punës, ditëve, muajve, stinëve, urimet etj. Brenda mundësive të kohës dhe të rastit, hetuam edhe zgjedhimin e disa foljeve, kur më shumë e kur më pak, po asnjëherë në mënyrë të plotë.

Mblodhëm në Mandricë çdo fjalë që dëgjuam, pa bërë dallim. Fjalorthi, si ç'do të shihet, ka materiale që s'patën nevojë për shpjegim dhe që i kemi futur aty vetëm për të treguar ekzistencën e tyre në të folmen e Mandricës. Një pjesë e mirë e fjalëve që regjistruam veç, sigurisht gjinden edhe në Tekstet që kemi botuar (shih. «Studime Filologjike» 1965, nr. 1); prapë, ne i regjistruam, që të kihet një ide e vokabularit të së folmes së Mandricës përmes këtij Fjalorthi.

Për interesin që paraqitin, kemi bërë këtu më poshtë një listë fjalësh të moçme shqipe të së folmes së Mandricës, apo trajtash tipike fjalësh të asaj të folmeje. Si ç'e kemi thënë në Studimin mbi Mandricën (shih po aty) dhe sikundër shihet nga Tekstet që kemi botuar, e folmja shqipe e atij fshati ka qenë ndikuar shumë, në fjalorin e saj, nga turqishtja, bullgarishtja dhe greqishtja. Po japim këtu më poshtë nga një listë fjalësh të këtyre gjuhëve që kanë hyrë në të folmen e Mandricës, për të formuar një ide të atij ndikimi të rëndësishëm. Të katër listat e fjalëve i kemi nxjerrë si nga Fjalorthi, ashtu edhe nga Tekstet.

Fjalë dhe trajta tipike shqipe të së folmes së Mandricës :

Anë (fund), anames, atyrme, avgjitkë, baltë (dhé), bardikë, bati, blarin (blegërin), botë (gjindje), cingë, cëngërin, cjorin apo cërin, çime, çoç, dalëtë moti (të), dilgon, djellë-a, fëmilë (familje), gërmis, gërqin'je, gëzitem, gji (gjë), gjigjem, ima (ëma), jes, ka (nga), o të kaj (do të ketë), kalsërë, karkanxolle, kërshtejkë, kllëç, kokove, kren (krej, nxjerr), llara (rralla), llotëron, mbrej, mbret (edhe për shtet), mbretëri, mih, ndanë (pranë), ni (një), njohësh (të) (të kuptosh), pagëzon, panerkë (shportë), përze, praptan, qutet, râhorë (ndeshje, luftë), shej, shklerisht, shklirë, shkla, shkopcitem, shprihem, shtillet (mbështillet, vishet), shtret, shtrofkë, tar (ar), tate, trim (djalë), tëpërton (depërton), vlon (fejoj), xallahin ose zallahin, xëngërmaroratë, zbjer ose xbjer (humb harroj), etj.

Turqizma:

Arkadashe, arnaute, Arnautllëk, asqer, asqerllëk, bair, bakshish, ballkan, be (bej), belik, bendis, bitis, bostan, budallâ, bunar, bylyk, çarshi, çorbaxhi, dejman, demek, derman, divan, djyljym, dushman, duva. dyqan, ferman, gjemixhi, gjesdis, gjoks, gjol, gjuz, hakë, halë (hallë), hambar, hanè, haznatar, hellall, heqim, herbab, hiç, insan, iliaz, jordashllar, kabil, kadënë, kahër, kaik, kaikçi, kasapllëk, kavak, këzan, kollaj, komshi, konak, kurbet, kurdis, kuvet, lufe (ylefe), masallë, memlym, Merixhî, merxhan, mëhallë, muharebe, mukadër, parà, pasha, qepengje, saba, sade, sallam, sefer, sefte, selam, senet, sini, sokak, sollak, surat, shëlmek, shimshir, temis, testembel, tjytjyn, ujdis, velaet, xhanëm, xharah, zaif, zamet, etj.

Bullgarizma e përgjithësisht sllavizma:

Ale, allahticë, banellë, barabunkë, barkanicë, bash, branë, bublluk, civik, çlenove, dànak, dërzhava, dostafçik, dovolen, drankë, dugan, dune, dupkë, dushit, duvar ose dvor, erà, gàrvan, gatankë, gollopar, gëbë, hojnë, jagodë, juves, kainço, kaltjankë, kallpakçe, kaskandis, kavall, këllvaç, klepkë, korlajkë; kratunë, lefe, legallo, leshnik, luljak, llajçukë, llapcinkë, maher, mallaçke, maslin, menit, muhlas, nai, ne, nishtu, peperungë, pernicë, piskat, poprellkë, pobit, potpis, prushkufallë, puduvit, pulpit, rapkë, rasboj, sankë, sërnë, sdrednoci, semesë, sjankë, sivë, smètin, snuvalkë, teqezesè, trudov den, uçe, udopstà, uduvicë, veçe ose veqe, vërnicë, vi, vojskaja, zagaçit, zakon (ligjë), zavit, zhalit, zhellvë, zhitel, etj.

Greqizma :

Anastis, ekshigjis, filladhe, gjozmë, mavrutë, pallamide, pangar, papo, papazia, prëftas, rigon, sinor, skulo, sos, shtefanos, trandafil, etj.

**A.**

**A.** ldh. kurse, porse: «a jatri që vjen është gjashta» (kurse... është i gjashti); «a nuk ni vini» (porse nuk na vini).
**allahticë-a,** ef. nepërkë.
**akull-i,** em.
**alè,** mb. i, e, të tillë-a: «jatra alè kanë» (të tjera të tilla gjëra kanë), «alè kle» (i tillë qe).
**allashtis,** ft. mësoj: «duhet të allashtisni të pini».
**andej,** ndf.
**andish,** ldh. që: «andish të vijë».
**anë-a,** ef. pikë e horizontit: «buriazit anë» (veriu), «jugës anë».
**april-i,** em. prilli.
**arë-a,** ef.
**arhangjel-i,** em. nëndori.
**arrihem,** fm. «sulen, nuk arrihen» (ndiqen, nuk e arrijnë shoqi-shoqin).
**arnaut-i,** em. përdoret dhe për ef; shm. arnaute-t.
**ashtu,** ndf. «ashtu erz sahati».
**at,** pd. «për at sebep».
**ata,** pd.
**ati,** pd. atij: «pas ati vjen peṣa» (vjen i pesti).

**ato,** pd. ata: «ato xhakolat qeshën» (ata burrat).
**aty,** ndf. «aty është Radoica?»
**austoz-i,** em. gushti.
**avgjitë-i,** em. arixhi, cigan, evgjit.

B.

**babo-ua,** em. gjyshi, gjyshja. «Timja babo, timet babora; toni babo, tontë babora» (gjyshi im, gjyshët tanë; gjyshja jonë, gjyshet tona).
**bajame-ja,** ef.
**bakërë-a,** ef. lojë me fiç e me pare.
**ballë-a,** ef. «më zëmp balla».
**ballgur-i,** em. bollgur.
**bamje-a,** ef. «dju bamjara».
**banellë-a,** ef. furkulicë: «dju banella».
**bar-i,** em.
**barabunkë-a,** ef. kulumbri. Edhe: **barabonkë-a.**
**bardiçke-ja, ef. lloj shtëmbe e vogël për të servirur raki.**
**bardiçkë-a,** ef. «Shingjergjit lule», aguliçe.
**barkanicë-a,** ef. dhallë.
**bark-u,** em. «barkut zëmbôrë» (dhimbje, sëmundje e barkut).
**bardë,** i, e, mb. bardhë. Zakonisht: **barzë.** «Leshëra barza» (leshëra të bardha).
**bati-a,** ef. bagëti.
**baxhanak-u,** em. «Timja baxhanak, tontë baxhanakë».
**besë-a,** ef. feja. «Tontë besa» (feja jonë, gjindja jonë).
**bën,** ft. bëj. E tashme: unë bën, bësh, bën, bëjmë, bëni, bëjnë». «të pimë, të bëjmë toka» (të trokasim kupat); «ç'o të bëj ai?» «ç'do të bëjë); «të bëhet keq»; «bën ngrohtë, bën toftë».
**bërdile-ja,** ef. krëhri i avlemendit.
**bije,** fpv. «shi bije», «bije shi, bije zborë». E pakryer: «bin'ja, bin'je, binish, binimë, binishtë, bininë ose binishnë».
**bilbil-i,** em.
**bilë-a,** ef. fëmijë. Shm. «bilëra».
**bisilok-o,** em. borzilok.
**bitim-i,** em. fund: «pipkat flinë maznë gjumë bitimit» (krymbat e mëndafshit flenë gjumin e madh të fundit).
**bizele-ja,** ef.
**Bithkuq-i,** em. katundi i Vithkuqit (Korçë). Edhe: **Viskuth.**
**ble,** ft. blej.
**bletë-a,** ef. Edhe: **bletkë-a.**
**blon,** ft. bluaj (unë).
**bolicë-a,** ef. buallicë. Mashkulli: **buoll.**
**botë-a,** ef. njerëzia, njerëzit: «nuk klanë bota ashtu»; «tontë bota» (gjindja jonë, që flasim një gjuhë).
**branë-a,** ef.
**brekë-a,** ef. «ni brekë, dju breka». Edhe: **brekëzë-a.**
**bres-zi,** em. «më ra brezi».
**breshër-i,** em.
**brëmnet,** ndf. Edhe: **mbrëmnet.**
**brisk-u,** em. brisku i rrojës; tjetri quhet **sikë.**
**brjumë-a,** ef. bryma.
**bubushangje-a,** ef. manushaqe.
**buçit,** ft. «aju buçit» (ai buçet).
**buf-i,** em. lloj zogu grabitqar.
**bukë-a,** ef. «u muhlas buka» (u myk). «Mbrëmnet bukë» (darka), «zëmërherë bukë» (dreka).
**bukorë,** mb. i, e, bukur: «bukorë kësmet»; «shum bukora gërneta» (saze, muzikë).
**bule-a,** ef. çupa më e madhe e shtëpisë. Edhe: **bulje-a.**
**bullashtis,** fm. shkon, shërohet: ekzema «nuk bullashtis; vetë heqimet më kanë sën» (thënë).
**bulle-a,** ef. kunata, kur është më e madhe se nusja; kur është më e vogël; e flasin në emër.

**bullkë-a,** ef. grua: «shumë falturë bullkave» (shumë të fala grave tuaja).
**bumbare-ja,** ef. lloj zhuzhaku, që të kafshon.
**bumbullin,** fpv. bubullin.
**bunar-i,** em. pusi: «bunara».
**buoll-i,** em. buall. Femra: **bolicë.**
**buri-a,** ef. qyngji i stufës.
**burias-zi,** em. «buriazit anë» (veriu).
**butë-a,** ef. shala e këmbës.
**bylyr-i,** em. brryli.

C.

**ca,** ppk. «përpara ca dit».
**cicë-a,** ef. sisa: «dju cica».
**cingë,** ndf. pak: «cingë ujë dua», «o të jes cingë» (do të mbetem, qëndroj). Edhe: **cingëlë.** «Cingëlë nglet» (ngjet pak).
**civik-u,** em. hirrë.
**cofis,** fint. cof, ngordh.

Ç.

**çahem,** fint. «u ça shisheja» (u thye).
**çaj-i,** em. «çait kupë» (kupë për çaj).
**çapë-a,** ef. shata.
**çdoherë,** ndf. kurdoherë.
**çë,** pp. «çë ishtë ai» (çfarë), «çë të sonë» (të thonë), «ç'o të bëj» (ç'do të bëj).
**çi,** pp. «çi ishtë ai» (çfarë).
**çiftè-a,** ef. pushkë gjahu.
**çime,** mb. i tillë: «çime mbret vjen, ashtu xallahijmë» (i tillë mbret vjen, ashtu flasim dhe ne, ashtu sillemi; bëjmë si ç'e do rasti).
**çorbë-a,** ef.
**çorçop-i,** em. lojë cingëlash.
**çukas,** ft. «të çukas sekërënë» (të rrah, të godas thekrën, për ta shirë).

D.

**dal,** fint. E tashme: «unë dal, del, del, dalim, delni, dalnë». E pakryer: «dolla, dolle, duoll, duollmë, duolltë, duollnë».
**dalë-a,** ef. «djellës dalë» (lindja).
**dallga-ja,** ef. dallga e detit.
**dallgan-i,** em. dallga e detit, deti me dallgë.
**dardë-a,** ef. dardhë. Edhe: **darzë.**
**dasmë-a,** ef.
**dele-ja,** ef.
**demerxhi-u,** em. hekurxhi.
**derkë-a,** ef. dritare.
**derr-i,** «derrësë mish» (mish i derrit).
**dë,** pf. në, ndë: «dë Sofje, dë punë, dë tefter».
**dëften,** ft. E tashme: «unë dëften, ti dëftesh, ai dëften, dëftejmë, dëfteni, dëftejnë». E pakryer: «dëften'ja, dëften'je dëftenish, dëftenimë, dëtfenishtë, dëfteninë».
**di,** ft. E tashme: «di, dish, di, dimê, dini, dinë». E pakryer: «din'ja, din'je, dinish, dinishmë, dinishtë, dininë».
**digjem,** fint.
**dimërë-i,** em.
**ditë-a,** ef. Shm. «dit-a»: «përpara ca dit».
**djado-ua,** em. gjyshi: «timja djado» ose «toni djado», «tontë djadora». Edhe: **babo.**

**djasë-a,** ef. djathi. Edhe: «u prish **djatha** pa e hozmë» (e hodhmë).
**djelë-a,** ef. e diela.
**djellë-a** ef. dielli. «Djellës dalë» (lindja), «djellës perënduar» (perëndimi). «Djellës lule» (luledielli).
**djesna,** ndf. djethnaj, dje.
**djullë-a,** ef. dylli.
**djylyndyshkë-a,** ef. dallëndyshe.
**dollma-ni,** em. parèt: «ni dollma, dju dollman».
**dollman-i,** em. sarma.
**dorë-a,** ef.
**doromaxhi-u,** em. zdrukthëtar.
**dosë-a,** ef. derr (femër ose mashkull).
**doskë-a,** ef. lloj loje.
**drankë-a,** ef. thana. «Qënit dranka» (trëndafil i egër).
**drisë-a,** ef. drithi.
**dru-ja,** ef. «Ca dru».
**dremit,** fint. E tashme: «dremit, dremit, dremit, dremitimë, dremitni, dremitinë». E pakryer: «dremitn'ja, dremitn'je, dremitish, dremitishmë, dremitishtë, dremitjinë». E kryer e thjeshtë: «dremita, dremite, dremiti, dremitmë, dremittë, dremitnë». E ardhëshme: «o të dremit, o të dremitësh, o të dremitë, o të dremitmë, o **të dremitni, o të** dremitinë». Lidhore: «të dremit, të dremitësh, të dremitë, të dremitmë, të dremitni, të dremitinë». Habitore: «dremitkam, dremitke, dremitka, dremitkemi, dremitkeni, dremitkanë». Hab. e kryer: «paskam dremitur» etj. Hab. e kryer e plotë: «të kisha dremitur» etj. Kushtore e pakryer: «o të dremitn'ja» etj. Kushtore e kryer: «o të kisha dremitur». etj. Urdhërore: «dremit, dremitni».
**dua,** ft. E tashme: «dua, dosh, do, domë, donl, donë». E pakryer: «desha, deshe. desh, deshmë, deshtë, deshnë».
**dugan-i,** em. sqifter.
**duhet,** fpv. «duhet të allashtisi të pini».
**dullap-i,** em. dollap.
**duman-i,** em. mjegull.
**dune-ja,** ef. ftua.
**durdullë-a,** ef. pema e manit.
**duvar-i,** em. mur.
**dyjta,** mb. i, e dyti-a: «dyjtën gjumë» (gjumin e dytë).
**dylgjer-i,** em. murator.
**dysheme-ja,** ef. «dju dysheme».

E.

**E,** pv. «nuk e ka».
**e,** ldh. «trizet e nëntë» (tridhjetë e nëntë).
**ecën,** ft. «ecë me shëndet».
**ekzemë-a,** ef.
**erë-a,** ef.
**eze,** ndf. edhe: «eze pak o të jesësh» (do të qëndrosh edhe ca).

F.

**faltura-t,** ef. E kemi dëgjuar vetëm shumës: «shum faltura bëni nga shqipëtarët njikohshim nga Mandrica» (shumë të fala u bëni nga shqiptarët e dikurshëm të Mandricës).
**faqe-ja,** ef. «me zëmp faqja, m'u frut faqja». Shm. «faqera».
**fare,** ndf. aspak: «rushi fare shi nuk kish, toçkërë koqja ishtë, timtë koqe ishtë» (rushi nuk pat fare shi — sivjet, — kokra e tij është e vogël, është e imtë kokra).
**farë-a,** ef. «koqe sojmë sadè për farë: ni koqe grurë, rush, rapkë; nuk sojmë ni koqe mollë; ni mollë sojmë» (thomi).
**fasule-ja,** ef. Edhe: **gjelbër fasul** (mashurka).

**femrë-a,** ef. «femrës kalë kush i sonë?» (si i thonë femrës së kalit?).
**ferrë-a,** ef.
**fik-u,** em.
**fishek-u,** em.
**fititin,** fpv. vetëtin.
**fli,** fint. fle. E tashme: «unë fli, flish, fli, flimë, flini, flinë». E pakryer: «flin'ja, flin'je, flinish, flinishmë, flinishtë, flininë«. «Pipkatë flinë» (krymbat e mëndafshit flenë).
**flori-a,** ef. «u xbuar floria» (u zhduk floriri).
**frëng-u,** em. domate: «dju frëngje».
**fronçezë-a,** ef. fron i vogël.
**frutem** (?), fint. fryhem: «m'u frut faqja nga zëmbi» (dhëmbi); «këmbët m'u frutnë».
**fshat-i,** em.
**furtunë-a,** ef.

G.

**garnetë-a.** ef. saze, muzikë: «shumë bukora garneta keni».
**gatankë-a,** ef. gjë e gjëzë.
**gëbë-a** (?), ef. këpushë.
**gëdalë-gëdalë,** ndf. dalëngadalë.
**gërçel-i,** em. rrudha në ballë: «dju gërçele».
**gërçitem,** fint. rrudhem: «u gërçitka balla, roba...»
**gërshërë-a,** ef. «të më japësh gërshërnë».
**gëzihem,** fint. gdhihem: «kush u gëzitë?» (si u gdhitë); «u gëzit» (u gdhi, gdhiu).
**gëzohem,** fint: «të gëzohenë, të mplakenë, të trashigohenë» (urim dasme). E tashme: «gëzohem, gëzohesh, gëzohet, gëzohemi, gëzoheni, gëzohenë». E pakryer: «gëzohen'ja, gëzohen'je, gëzohenish, gëzohenishmë, gëzohenishtë, gëzoheninë». E kryer plo. «unë jam gëzuar» etj. E kryer e tejkal. «unë klesha gëzuar» etj. (qeshë gëzuar). E ardhëshme: «o të gëzohem» etj. Lidhore e tash. «të gëzohem» etj. Lidhore e pakry. «të gëzohen'ja» etj. Lidh. e kry. «unë të jam gëzuar, të je gëzuar, të ishtë gëzuar, të jemi gëzuar, të jeni gëzuar, të janë gëzuar». Lidh. e kry. e tejkal. «unë të klesha g., të kle g., të kle g., të klemë g., të kletë g., të klenë g.,» Habit. e tan. «unë u gëzuokam, u gëzuoke, u gëzuoka, u gëzuokemi, u gëzuokeni, u gëzuokan». Kusht. e tan. «unë qosh gëzohem, qosh gëzohesh» etj. Urdh. «gëzohu, gëzohuni».
**glimb-i,** em. driza: «dju glimba».
**glishtë-i.** em. gishti: «më zëmp glishti».
**glu-ja,** ef. gjuri: «ni glu, dju gluja, më zëmbnë glunjatë».
**glufë-a,** ef. Edhe: «po zbiret **gluha**».
**gomar-i,** em. «Gomarit kollë (kolla e mirë).
**gomarezë-a,** ef. mushkonjë, konupe.
**grerëzë-a,** ef. grerë.
**grihë a,** ef.
**grën'jore-a,** ef. mjeshtër i punimit të mëndafshit. Edhe: **tohunxhi.**
**grisem,** fint. «dju qilime kishmë, u grisnë».
**groshë-a,** ef. çoçull.
**grurë-i,** em.
**gruvë-a,** ef. grua: «ky gruva» (kjo...).
**gunë-a,** ef. lloj palltoje me mëngë, jo allafrënga; asaj allafrënga i thonë **pallto.**
**guri-i,** em. «dju gura».
**guricë-a,** ef. gorricë.
**gushtericë-a,** ef. hardhucë.

GJ.

**gjalpë-a,** ef.
**gjarpërë-i,** em. «dju gjarpërin'j».
**gjashta,** mb. i, e gjashti-a.
**gjelbër.** mb. «gjelbër fasul» (mashurkë)

**gjellë-a,** ef. frëngjevet gjellë» (gjellë me domate), «fasulevet gjellë, kungullit gjellë» etj.
**gjen,** ft. gjej. E tashme: «unë gjen, gjesh, gjen, gjejmë, gjeni, gjejnë».
**gjenç-i,** em. fëmijë: «dju gjençëra». Edhe: **këzan.**
**gjigjem,** fint. dëgjoj me vesh: «nuk gjigjem».
**gjimon,** fpv. gjëmon.
**gjis,** mb. gjithë.
**gjoks-i,** em.
**gjozmë-a,** ef. dhiozmë.
**gjumsënatë-a,** ef. mesnata.
**gjumë-i,** em. «pipkatë katrë gjumë flinë: seftejçmin gjumë niher flinë, dyjtën gjumë pëstaj, trinë, ze maznë gjumë bitimit».
**gjunah-u,** em. «gjunahet».
**gjus-zi,** em. vjeshta.
**gjyveç-i,** em. lloj gjelle, turli.

**H.**

**ha,** ft. E tashme: «unë ha, hash, ha, hamë, hani, hanë». E pakryer: «han'ja, han'je, hanish, hanimë, hanishtë, haninë».
**haj,** ft. eja: «haj të pimë»
**hàle-a,** ef. «hàlera», gra që kanë qenë ose janë martuar.
**hàlezë-a,** ef. «maze hàlezë« (lija), «toglë hàlezë» (fruthi).
**halle-ja,** ef. grua, zonjë, motra e nënës ose e babait: «timja halle, tontë hallera; iku hallja; hallen s'e kam kutu».
**halles-zë-a,** ef. grua: «shkojti ni halles andej».
**hashlladis,** ft. sharrtoj: «ne hashlladismë».
**hap,** ft. E tashme: «unë hap, ti hapësh, hap, hapmë, hapni, hapnë». E pakryer: «hapn'ja, hapn'je, hapish, hapijmë, hapishtë, hapjinë». E kryer: «hapa, hape, hapi, hapmë, haptë, hapnë». E ardh. «unë o të hap» etj. Lidh. e tash. «unë të hap» etj. Lidh. e pakry. «të hapn'ja». Lidh. e kry. «të kisha hapur» etj. Kusht. e tan. «qosh të hap» etj. Urdh. «hap, hapni».
**helq,** ft. heq. «shumë kemi helqur» (hequr, vuajtur), «shum holkëmë».
**heqim-i,** em. «heqimet më kan sën» (thënë).
**herë-a,** ef. «ni her' flinë» (një herë flejnë); **zëmërherë** (dreka).
**hez,** ft. hedh: «u prish djatha pa u hozmë».
**hënë-a,** ef. dita e parë e javës.
**hi-ja,** ef. hi.
**hipën,** ft. hyp. E tashme: «unë hipën, hipësh, hipën, hipimë, hipni, hipinë».
**hishme,** mb. «shum hishme ishtë ky gruva».
**hizem,** fint. hidhem. E tashme: «unë hizem, hizesh, hizet, hizemi, hizeni, hizen». E pakryer: «hizen'ja, hizen'je, hizenish, hizenishmë, hizenishtë, hizeninë». E kryer: «u hoza» etj.
**hojnë-a,** ef. dëllinjë.
**hosten-i,** em.
**hundrë-a,** ef. hudhër.
**hundë-a,** ef. «dju hunda».

I.

**I,** pv. «I përskat rushtë».
**ikën,** ft. «kushërintë iknë».
**ilqas-zi,** em. pranvera.
**insan-i,** em. njeri: «shum shpet lizen me insannë arnautet» (shumë shpejt lidhen me njeriun, me tjetrin, shqiptarët; janë të afruar shumë).

**J.**

**jagodë-a,** ef. luleshtrydhe.
**jam,** fint. E tashme: «unë jam, je, ishtë, jemi, jeni, janë». E pakryer: «isha» etj? («isha në Ivajlovgrad»), po edhe «klesha, kleshe» etj? («klesha lizur me ata», isha lidhur). E ardh. «unë o të jam» etj. Kusht. «o të klesha,

o të kleshe, o të kle, o të klemë, o të kleni, o të klenë». Habit. «klekam, kleqe, kleka, kleqemi, kleqeni, klekanë». Lidh. «të jam, të je» etj.
**jap,** ft. E tashme: «unë jap, japësh, jep, japmë, jepni, japnë». E pakryer: «jipn'ja, jepn'je, jepish, jepishtë, jepishtë, jepinë». «Të më japësh gërshërnë».
**jarebicë-a,** ef. thëllëzë.
**jatër-a, -i,** ppk.
**je,** ldh. dhe: «shëndet je kësmet». V. **e, eze, ze.**
**jelp-bi,** em. elb.
**jordek-u,** em. rosë (mashk. dhe fem.).
**jes,** fint. mbes: «o të jes cingë, eze pak o të jesësh».
**jugë-a,** ef. «jugës anë» (drejtimi i jugut, në horizont).

K.

**ka-u,** em. shm. «qe».
**kaçezë-a,** ef. lule kaçe.
**kaçkë-a,** ef. arrë.
**kafas-zi,** em.
**kafentë,** mb. i, e, kafejtë, bojë **kafe.**
**kainço-ua,** em. kunat. «Timja kainço, tontë kainçora».
**kainë-i (?),** lloj druri.
**kajsi-a,** ef.
**kakavidë-a,** ef. flutura e mëndafshit.
**kalem-i,** em. këllku.
**kalë-i,** em. (mashk. dhe fem.). V. **pelë.**
**kalsër,** mb. i, e kaltër.
**kallekrë-a,** ef.
**kallpak-u,** em. «dju kallpakë».
**kam,** ft. E tashme: «unë kam, kesh, ka, kemi, keni, kanë». E pakryer: «kisha, kishe, kish, kishmë, kishtë, kishnë». E ardhëme: «unë o të kam, o të kesh, o të kaj, o të kemi, o të keni, o të kanë».
Edhe: «s'ka të shkosh» (s'do të shkosh). Lidh. «të kem, të kesh, të kaj, të kemi, të keni, të kanë». Lidh. e pakry. «të kisha, të kishe« etj. Habit. «paskam, paske, paska, paskemi, paskeni, paskan». «Me shëndet paç» (përgjigje urimit: «me shëndet»). «U ka përmirë» (është përmjerrë).
**kamare-ja,** ef.
**kandes-zi,** em. këndez.
**kapllëxhè-ja,** ef. lloj elbi.
**kapushë-a,** ef. këpusha e dhenve.
**karpus-zi,** em.
**kartall-i,** em. shqiponjë.
**kasabà-ja,** em.
**kasabalotkë-a,** ef. qytetarkë.
**katër,** ndf.
**katra,** mb. e **katra.**
**kaun-i,** em. pjepër.
**kaurmà-ja,** ef. lloj gjelle.
**kavak-u,** em. plep.
**kave-ja,** ef. «kaves kupë» (filxhani i kafes).
**këllon,** fint. kullon.
**këllvaç-i,** em. qukapiku.
**këmbë-a,** ef. «këmba m'u frut», «këmbët» e avlemendit.
**këmisha-a,** ef.
**kërçan-i,** em. breshnicë.
**kërlashe-ja,** ef. lloj këpushe e madhe, e keqe.
**këndon,** ft. këndoj.
**kësmet-i,** em. «hajde shëndet e bukorë kësmet» (urim, kur pinë).
**këtë,** pd. «me këtë jemi kushëri».
**këzan-i,** em. fëmijë.
**këzolxhè-ja,** lloj gruri.

**kla,** fint. E tashme: «unë kla, klash, kla, klamë, klani, klanë». E pakryer: «klan'ja, klan'je, klanish, klanishmë, klanishtë, klaninë». Edhe: «ato xhakolat qeshën, ti kla» (për: klash).
**kërcas,** ft. thyej. E tashme: «unë kërcas, kërcasësh, kërcet, kërcasmë, kërcitni, kërcasin». «Kërcas kaçkënë» (thyej arrën).
**klepkë-a,** ef. qerpiku. «Dju klepka».
**kohë-a,** ef. kovë: «dju koha».
**klishë-a.** ef. kishë.
**klumështë-a,** ef. qumësht: «klumështa u prish». «Zënë klumësht» (kos).
**koç-i,** em. dash.
**kohë-a,** ef. «nga koha i sonë Toska» (ç'prej kohësh, që herët); «jernë kohrat ashtu»; «rëndë kohë» (zagushi); «verës kohë« (verë).
~~**kohë-a,** ef. kovë: «dju koha»~~
**kokalçinkë-a,** ef. nyja e poshtme e këmbës.
**kollë-a,** ef. «gomarit kollë» (kolla e mirë).
**kontra,** pf. «venish kontra» (vinin kundër njëri-tjetrit), «kle kontra».
**konapar-i,** em. shm. «kopanare». Evgjitë nomadë që punojnë govata.
**kopsë-a,** ef. «dju kopsa».
**koqe-ja,** ef. kokër, farë: «koqe rush, grurë, rapkë», porse nuk thuhet «koqe mollë, dardhë etj».
**korës-i,** em. «korës muaj» (qershor).
**korlajkë-a,** ef. kunë: «dju korlajka».
**kor,** ft. korr: «kormë drisë» (korrëm drithë).
**korlahem,** fint. përkundem: «korlahet këzani dë korlajkë».
**kose-ja,** ef. mëllenjë.
**koskë-a,** ef.
**kostenjë-a,** ef. gështenjë.
**kotorak-u,** em. maçok.
**krahë-u,** em. shpinë: «neriu ni krahë ka», «e mban dë krahë».
**krastis,** ft. krasis.
**kravama-a,** ef. drapër.
**krastravec-i,** em. Edhe: **sallatë.**
**kratunë-a,** ef. susak.
**krekëzë-a,** ef. lloj druri.
**kremne-ja, e,** ef. e kremte: «ze të kremnera, ze të djela, ze të punëshme dit, gjis punojmë».
**krëhër-i,** em. krëhëri i avlemendit.
**krimb-i,** em.
**kruq-i.** em. shtatori.
**krushk-u,** em. «timja krushk, tontë krushqërin».
**krushkë-a,** ef. «timja krushkë, tontë krushkëra».
**krushkë-a,** ef. llambë elektriku.
**kruve-ja,** ef. «kruves zëmbôrë» (dhimbja e kryes). «Më mbush dë kruve» (më qëllon në krye).
**ksehem,** fint. kthehem: «kur u ksesha nga Plovdiv» (kur u ktheva. . .).
**ku,** ndf. «ku u xborët?» (ku humbët).
**kuckuc-i,** em. lojë këmbëçalthi.
**kuçkë-a,** ef. buçë.
**kuko-ua,** em. qyqe.
**kukumjafko-ua,** em. kukumjaçkë.
**kukule-ja,** ef. mëshika e mëndafshit.
**kumbullë-a,** ef.
**kunështisem,** fint. përzjehem, afrohem: «o të kunështisemi, o të zallahijmë»; «shum shpet kunështisen, lizen me insannë arnautet».
**kungull-i,** em.
**kupkë-a,** ef. «rakisë kupkë».
**kupë-a,** ef. bardhak uji.
**kupucë-a,** ef.
**kupucaxhi-u,** em. këpucar.
**kupus,** ft. këpus: «më kuputi veshënë».
**kuqe,** mb. i, e kuqe: «kuqe djalë, kuqe mollë».
**kur,** ndf.
**kurumbli-a,** ef. kulumbri.

**kusinkë-a,** ef. kusi.
**kush,** ndf. qysh, si: «femrës kalë, kush i sonë? «Kush u gëzitë?»
**kushëri-u,** em. «sefteshmi kushëri, sefteshmëra kushëri (kushërinj të parë); k. ndyjtë; tria k.; ku m'ishtë tria k. (ky më është kushëri i tretë); «me këtë jemi treta kushëri»; «kushërintë iknë».
**kutu,** ndf. këtu: «nuk e ka kutu» (nuk gjindet, nuk është këtu).
**ky,** pd. ky, kjo: «ky gruva, ky burë».

L.

**la,** ft. E tashme: «unë la, lash, la, lamë, lani, lanë». E pakryer: «lan'ja, lan'je, lanish, lanimë, lanishtë, laninë». E kryer: «lava, lave, lau, lamë, latë, lanë». E kry. plo. «kam larë» etj. E kryer e tejka. «kisha larë». E ardh. «o të la, o të lash, o të lajë, o të lamë, o të lani, o të lanë». Lidh. e tash. «të la» etj. Habit. «lakam, lake, laka, lakemi, lakeni, lakanë». Kusht. «qosh la« etj.
**lakër-a,** ef.
**le,** ft. E pakryer: «lin'ja, lin'je, linish, linishmë, linishtë, linishnë». E kryer: «lasha, lashe, la, lamë, latë, lanë».
**legallo-ua,** em. qymezi i pulave.
**lehzë,** ndf. lehtë.
**lejmon-i,** em.
**lepur-i,** em. «ni qën që paramas lepurin»; «shi me zborë, lepurit dasmë»
**lesh-i,** em. floku: «leshëra barza».
**lëkurë-a,** ef.
**li,** prapashtesë pyetse bullgare: «shosh-li?» (e sheh?), «vërtet-li» (vërtet?).
**lilikuq-i,** em. lulkuq.
**lipà-ja,** ef. druri i blirit.
**lis-i,** em. «zoktë van te lisi; e preu sëpata lisin».
**lizem,** fint. lidhem. E tashme: «unë lizem, lizesh, lizet, lizemi, lizeni, lizen». E pakryer: «lizen'ja, lizen'je, lizenish, lizenishmë, lizenishtë, lizeninë». E kryer: «u liza, lize, u liz, u lizëm, u liztë, u liznë». E kry. plo. «jam lizur» etj. E kry. e tejka. «klesha lizur» etj. E ardh. «o të lizem» etj. Lidh. e pakry. «të lizen'ja» etj. Lidh. e kry. «të lizem». Lidh. kry. plo. «të jam lizur» etj. Habit. «u lizkam, u lizke, u lizka, u lizkemi, u lizkeni, u lizkanë». Kusht. «o të lizen'ja» etj. Urdh. «lizu, lizuni».
**lon,** ft. E tashme: «unë lon, luosh, luon, luojmë, luoni, luojnë».
**lopë-a,** ef.
**luaj,** fint.
**lugë-a,** ef.
**lule-ja,** ef. «Shilmitri lule» (krisantem).
**luljak-u,** em. jargavan.

Ll.

**llajçukë-a,** em. luleshqerre.
**llakro-ua,** em. zverk.
**llambë-a,** ef.
**llapcinkë-a,** ef. papuçe fëmijësh, prej çorapi ose lëkure.
**llapsosem,** fint. llafosem.
**llarë,** ndf. rrallë.

M.

**macë-a,** ef. trueza: «dju maca».
**maçalis,** ft. përtyp.
**maçe-ja,** ef. v. **kotorak.**
**maçko-ua,** em. mace e vogël. Edhe: **maçkozë.**
**maher-i,** em. thikë: «pleqtë soninë sikë».
**maj-i,** em.
**majdanos-zi,** em. magdanoz.
**mallaçkeja-ja,** ef. i vogli i buallicës, kotorr.
**man-i,** em. Edhe: **manezë-a.**

**mar,** ft. E tashme: «unë mar, mer, mer, marmë, merni, marnë». E pakryer: «mern'ja, mern'je, merish, merinë, merishtë, merinë».
**marë-a,** ef. e martë.
**mars-i,** em.
**martohem,** fint.
**marule-ja,** ef.
**mas,** ft. E tashme: «unë mas, masësh, mat, masmë, matni, masnë». E pakryer: «masn'ja, masn'je, masish, matimë, matishtë, matinë».
**masallë-a,** ef. përrallë.
**maslin-i,** em. ulli.
**mashà-ja,** ef. mashë
**mashkull-i,** em. «mashkull kalë» (kali), «femër kalë» (pelë).
**mashtehù-i,** em. njerk: (timja **mashtehù, tontë mashtehàn».**
**mashtehë-a,** ef. njerka: «timja mashtehë, tontë mashteha».
**mashtrëk-u,** em. pjatë: **«dju mashtriq».**
**maz-e,** mb. i, madh-e. «Maznë gjumë» (gjumin e madh, vdekjen):
**mba,** ft. mbaj.
**mbetem,** fint. qëndroj: «mbetuni me shëndet» (përshëndetje kur largonet dikush).
**mbjell,** ft. E tashme: «unë mbjell, mbjellësh, mbjell, mbjellmë, mbjellnë, mbjellnë». E pakryer: «mbilln'ja, mbilln'je, mbillish, mbillimë, mbillishtë, mbillinë» E kryer: «mbolla, mbolle, mbolli, mbuollmë, mbuolltë, mbuollnë». E kry. plo. «kam mbjellë» etj. E ardh. «o të mbjell». Lidh. «të mbjell» etj. Habit. «mbjellkam, mbjellke, **mbjellka,** mbjellkemi, mbjellkeni, mbjellkanë».
**mbreh,** ft. mpreh (briskun etj).
**mbreh,** ft. vë qetë në kular.
**mbret-i,** em.
**mbrëmnet,** ndf. «hëngrëm mbrëmnet **bukë» (darkë); «mbrëmnet o t'hamë bukë»** (në mbrëmje). Edhe: **brëmnet.**
**mbush,** ft. «më mbushi dë mjekrë» (më qëlloi).
**mbylltur,** ndf. «derka mbylltur ishtë» (dritarja...).
**me,** pf. «klesha lizur me ata», «ecë me shëndet».
**melon-i,** em. miljon.
**meshè-ja,** ef. lis.
**më,** pv. «primidisi më zëmp»; «të më japësh dorënë»; «m'u frut faqja».
**mëmë-a,** ef. 1) «timja mëmë, tontë mëma».
2) mbretëresha bletë.
**mëndyn,** fint. përsëritet: «ekzema shërohet, pap mëndyn».
**mërkurë-a,** ef.
**mësallë-a,** ef. picetë me të cilën mbështjellin bukën në shtëpi ose në arë.
**mik-u,** em.
**milë-a,** ef. mija: «ni mila» (e njëmijta).
**mirënatë-a,** ef. urim për natën.
**miris,** fint. mban erë: «bubushangje shum bukor miris».
**mirnëmëngjes-i,** em. urim për mëngjezin. Edhe: **mirmëngjes.**
**mirëmbrëm-a,** ef. urim për mbrëmjen.
**mirtèni,** urim: qofshi mirë. E thonë më çdo rast të ditës, kur ndahen.
**mish-i,** em.
**Mit-i,** em. Dhimitër: shm. Mitëra.
**mizë-a,** ef.
**mjaltë-a,** ef.
**mjekrë-a,** ef.
**mjeshtër-i,** em. i pari i muratorëve.
**moçkërë,** mb. i moçëm. V. **toçkërë.**
**morë-a,** ef. morri.
**mollë-a,** ef.
**motër-a,** ef. «timja motër, timet motra».
**mplakem,** fint. «të mplakenë, të trashigohenë» (urim dasme); «të ritet, të mplaket» (urim për fëmijët).
**muhlaset,** fint. «u muhlas buka» (u myk).
**mundem,** fint. «s'un të shkron» (s'mund të shkruaj).
**mundafsh-i,** em.
**muoj-i,** em. «mazi muoj» (muaji i madh, janari), «togli muoj» (shkurti).

**mustaqe-ja**, ef. «m'u zbardhnë mustaqet».
**mushkë-a**, ef.
**mushtrak-u**, em. nevojtore.
**muzhdrafkë-a**, ef. lloj druri.

N.

**natë-a**, ef.
**nda**, ft. ndaj: «ndajnë arnautet» (dallohen).
**ndëlej**, ft. ndjej: «Perëndi ndëlemë». Edhe: «**ndile** Zot».
**ndrin**, fint. ndrij.
**ndritë-a**, ef. dritë.
**ndyjtë**, mb. i, e dytë: «ndyjtë kushëri».
**ne**, pv. «ne ni qjutet kemi».
**ne**, pf. «kemi ni shqipëtarkë ne dvori» (te muri, — në fotografi).
**neve**, pv. «neve kemi».
**neri-u**, em. njeri.
**në**, num. një. Zakonisht: **ni**.
**nëntë**, num.
**nëntëmeta**, mb. i, e nëntëmbëdhjetë-a.
**nga**, ldh. «nga koha i sonë Toska»; «kemi ni shqipëtarkë nga shkoj» (ka kohë).
**ngas**, ft. E tashme: «unë ngas, ngasësh, nget, ngasmë, ngitni, ngitinë». E pakryer: «ngitn'ja, ngitn'je, ngitish, ngitimë, ngitishtë, ngitinë«.
**nglas**, fint. ngjas: «të nglat» dhe: «cingëlë nglet».
**nglindem**, fint. nginjem: «u nglindmë, nglinduni».
**ngopem**, fint. «u! nuk o ngopesh?»
**ngrën**, ft. ngre. E tashme: «unë ngrën, ngrësh, ngrën, ngrëjmë, ngrëmë, ngrëjnë«. E pakryer: «ngrën'ja, ngrën'je, ngrënish, ngrënimë, ngrënishtë, ngrëninë».
**ngroftë**, ndf. «bën ngroftë».
**ngjyen**, ft. ngjyej. E tashme: «unë ngjyen, ngjyesh, ngjyen, ngjyejmë, ngjyeni, ngjyejnë». E pakryer: «ngjyen'ja, ngjyen'je, ngjyenish, ngjenimë, ngjyenishtë, ngjyeninë».
**ni**, num. një: «shkojti ni hales». Edhe: **në**.
**nikohshim**, mb. i, e, dikurshëm: «shqipëtarëtë nikohshim».
**nite-ja**, ef. pjesët e avlemendit që ngrihen e ulen.
**nizeta**, mb. i, e njëzet-a.
**nuk**, ndf.
**nun-i**, em. «timja nun, tontë nunërin».
**nun-e** ef. «timja nune, tontë nunëra».

Nj.

**njoh**, ft. kuptoj. E tashme: «unë njoh, njohësh, njoh, njohmë, njohni, njohnë». E pakryer: «njohn'ja, njohn'je, njohish, njohimë, njohishtë, njohishmë».

O.

**o**. «o të ngopesh», «o t'vesh» (do të...).
**ojën-a**, ef. lojë.
**omus-zi**, em. shpatulla: «timet omuse djutë» (dy shpatullat e mia).
**opingë-a**, ef.

P.

**paçë-a**, ef. paçà.
**pagëzon**, ft. pagëzoj.
**pak**, ndf. «pak o të jesësh».
**pap**, ndf. prapë.
**papar-i**, em. damalugu.
**paramàt**, ft. ndjek: «kam në qën që paramàs lepurin».

**parëmëndë-a,** ef.
**pas,** ndf. mbas.
**patatë-a,** ef. «dju patata».
**patë-a,** ef. njësoj edhe për mashkullin.
**patkëzë-a,** ef. zog pate.
**patllaxhane-ja,** ef.
**pazareps,** ft. bëj pazar.
**pelë-a,** ef. grua përtace. Për femrën e kalit nuk e përdorin dhe s'kanë emër.
**pen-i,** em. peri.
**peper-i,** em. piperkë.
**peperungë-a,** ef. flutur.
**pepkë-a,** ef. thimthi i sisës.
**Perëndi-u** (?), em. «Perëndi, ndëlemë gjunahet».
**perënduar,** eas. (?) «djellës perënduar» (perëndimi).
**pes,** num. pesë.
**pesa,** mb. i, e pesta: «kju është pesa që vjen kutu; a jatri që vjen, gjashta; pas ati ishtë shtata».
**peshqir-i** em. Edhe: **stembel.**
**petë-a,** ef. lakror: «lakrësë petë, kungullit petë, petë-petë» (lakror vetëm me ve e me djathë).
**për,** pf. «për shumë vjeç» (urim për festë).
**përç-i,** em. cap.
**përmirem,** fint. «u ka përmirë» (është përmjerrë).
**përpara,** ndf. «përpara ca dit isha ne Ivajlovgrad».
**përskas,** ft. spërkas: «përskas rushtë».
**pi,** ft. «raki ze tytyn nuk pi», «haj të pimë», «juve të pini».
**pipkë-a,** ef. krymbi i mëndafshit.
**pite-ja,** ef. hualli. Shm. «pitera».
**plak-u,** em. «plaku djado, pleqtë djadora» (stërgjyshët).
**plakë-a,** ef. «plaka babo, plekat babo» (stërgjyshet).
**plakëri-a,** ef. pleqëri.
**pleshtë-a,** ef. pleshti.
**prapa,** ndf. «prapa klishën» (prapa kishës).
**prashis,** ft. «ato prashisnë».
**prazhgë-a,** ef. llastikë.
**premedis-i,** em. belt, mejdisi. Edhe: **primidis.**
**pres,** ft. E tashme: «unë pres, presësh, pret, presmë, pritni, presnë».
**presh-i,** em. «dju presh».
**pres,** ft. «e preu sëpata lisin».
**prëmte-ja,** ef. e premte.
**primidis-i,** em. «primidisi më zëmp». Edhe: **premedis.**
**prishem,** fint. «klumështa u prish».
**prongjize-ja,** ef. hekuri që hap pëlhurën në avlëmend, që të mos mblidhet.
**prushkuvall-i,** em. jastëk.
**po.** «po zbiret gluha».
**poprelikë-a,** ef. Kur gratë mblidhen bashkë për të tjerrur, kjo quhet «poprellkë». Tani «poprellkën» e bëjnë edhe për duhan etj.
**portofei-i,** em. portofoll.
**portokale-ja** ef.
**poture-t,** ef. shm. «timet poture».
**pulë-a,** ef.
**pullatkë-a,** ef. zog pule, pulastre.
**punë-a,** ef. «punë tepërzë, u ça shisheja» (nga përdorimi i tepërt...)
**punëshme,** e, mb. «e punëshme ditë» (ditë punëtore).
**pungje-ja,** ef. kuletë: «dju pungjera».
**punon,** ft. punoj. E tashme: «unë punon, punosh, punon, punojmë, punoni, punojnë». E pakryer: «punon'ja, punon'je, punonish, punonimë, punonishtë, punoninë». E kryer: «punojta, punojte, punojti, punojtmë, punojttë, punojtnë«. E kry. plot. «kam punuarë, kesh ose qe punuarë, ka punuarë» etj. E ardh. «o të punon» etj. Lidh. «të punon» etj. Habit. «punuokam, punuoke, punuoka, punuokemi, punuokeni, punuokanë». Kusht. «qosh punon» etj. Urdh. «puno, punoni», ose: «pëno, pënoni».
**putis,** ft. ujís, i jap ujë.

Q.

**qafë-a**, ef.
**qeckë-a**, ef. kec.
**qengjezë-a**, ef. qengj.
**qepë-a**, ef.
**qereç-i**, em. gëlqere.
**qershi-a**, ef.
**qesh**, ft. «ato qeshën».
**qeveris-i**, em. nenexhik.
**që**, !dh.
**qën-i**, em. «qëni të vdesë nga manat» (aq sa vdes qeni nga manat, aq vdes njeriu nga rakia, të ngrënët etj); «qënit drankë» (trëndafil i egër).
**qëron**, ft. «qërojmë drisënë dë arë» (pastrojmë drithin në arë, tëharrim).
**qi**, ft. «t'i qi koskënë»; «t'i qi zezënë besë»; «t'i qi mëmëtin» etj.
**qilim-i**, em. «dju qilime».
**qinda**, mb. i, e njëqinda.
**qiqërë-a**, ef.
**gjutet-i**, em. «ne ni gjutet kemi: sojnë Edernenë; tjeratë i sojmë kasabaj». Edhe: **qutet, qjutet.**
**qoftè-ja**, ef.
**qopri-u**, em urë.
**qormaçe-ja**, ef. lojë symbyllazi.

R.

**ràbë-a**, ef. arabaja, karroca, automobili.
**raki-a**, ef.
**rapkë-a**, ef. misri.
**rasboj-i**, em. avlëmend.
**re-a**, ef. reja.
**rëndë**, mb. «rëndë kohë» (kohë e rëndë, zagushi).
**ri**, ft. E tashme: «unë ri, rish, ri, rimë, rini, rinë». E pakryer: «rin'ja, rin'je, rinish, rinimë, rinishtë, rininë».
**rigon-i**, em.
**ritem**, fint. «të ritet, të mplaket, të bëhet me leshëra të barza» (urim për fëmijët), «toçkërat ritenë» (të vegjlit rriten).
**robe-a**, ef. shm. «robatë».
**rodan-i**, em çikriku i pusit.
**rush-i**, em. shm. «rushtë».

Rr.

**rrëcirë-a**, ef. errësirë.
**rrogos-zi**, em. «dju rrogozë».

S.

**s'**, ndf. «s'ka të shkosh» (s'do të shkosh).
**sadè**, ndf. vetëm.
**sahat-i**, em. «ashtu erz sahati» (koha).
**sahem**, fint. thahem. E tashme: «unë sahem, sahesh, sahet, sahemi, saheni, sahenë». E pakryer: «sahen'ja, sahen'je, sahenish, sahenishmë, sahenishtë, saheninë». E kryer: «u sasha, u sashe, u sa, u samë, u satë, u sahnë». E kry. plo. «jam sarë» etj. E ardh. «o të sahem» etj. Lidh. «të sahem». Lidh. kry. «të klesha sarë» etj. Habit. «u sakam» etj. Habit. e kry. «klekam sarë» etj. Kusht. «qosh sahem» etj. Urdh. «sahu, sahuni».
**sallatë-a**, ef. Edhe: **krastravec.**
**sart**, ndf. thartë: «ze un nuk ha sart, ze raki nuk pi, ze tytyn».
**sebep-i**, em. «për at sebep» (nga ai shkak).

**seftejshmi,** mb. i pari: «sefteshmi kushëri, sefteshmëra kushërin».
**sekërë-a,** ef. thekër.
**serin-i,** em. fresk.
**setullë-a,** ef. sqetull.
**sëmbon,** fpv. dhemb trupi.
**sëmundë-a,** ef. «veremit sëmundë« (tuberkulozi).
**sëpatë-a,** ef.
**sier-i,** em. thier.
**sikë-a,** thikë. Edhe: **maher.**
**sivë-a,** ef. bojë hiri.
**sju-u,** em. sy.
**smètin-i,** em. kajmak.
**snuvalikë-a,** ef. sovajka e avlëmendit.
**sobë-a,** ef. por.
**sobaxhi-u,** em. ai që bën pore.
**som,** ft. thom: «i sojmë kasabaj» (i thomi, i quajmë); «tashi ashtu e sonë: jemi nga Viskuthi» (e tregojnë); «pleqtë soninë» (thonin, tregonin).
**spanaq-i,** em.
**spurdik-u,** em. lloj zogu. Shm. «spurdiq».
**stembel-i,** em. Edhe: **peshqir.**
**sua-oi,** em. thua: «a nd'isht ni, — sua; a nd'ish dju, — son'j» (në se është një, themi «sua»; në se është dy, themi «sonj«). Edhe: «sonjtë më zëmbin».
**sulem,** fm. «sulen, nuk arrihen» (rendin, ndjekin njëri-tjetrin).
**supë-a,** ef.

Sh.

**shal-i,** em. shall.
**shej-i,** em. shenjë: «ni shej: shpin' e mban dë krah; çë ishtë ai?» (një send: shtëpinë etj). Përdoret ndër gjë e gjëza.
**sheqer-i,** em.
**shëlmek-u,** em. kërmill.
**shëndet-i,** em. «me shëndet» (urim kur pinë); «me shëndet paç» (përgjigja). «Mbetuni me shëndet» (thonë kur ikin); «ecëni me shëndet» (u thonë atyre që ikin).
**shërohem,** fint.
**shi-a,** ef. shiu. «shi bije» ose «bije shi». «Shi me zborë, lepurit dasmë».
**Shilmitër-i,** em. Shëmitri. «Shilmitrit lule» (krisantem).
**shimshek-u,** em. rrufe.
**Shingjergj-i,** em. «Shingjergjit lule» (aguliçe); edhe: **bardiçkë.**
**Shinikol-i,** em. dhjetor.
**Shinmitër-i** em. tetor.
**shishè-ja,** ef.
**shkla-u,** em. bullgar. Shm. «shkletë».
**Shklerlik-u,** em. Bullgaria.
**shklirë-a,** ef. bullgare.
**shkon,** ft. shkoj: «neve kemi ni shqipëtarkë... nga shkoj» (ka mot). «S'ka të shkosh dë Turqi» (nuk do të shkosh).
**shkozë-a,** ef.
**shkron,** ft. shkruaj. E tashme: «unë shkron, shkrosh, shkron, shkrojmë, shkroni, shkrojnë». E pakryer: «shkron'ja, shkron'je, shkronish, shkronimë, shkronishtë, shkronishnë».
**shpet,** ndf. shpejt.
**shpi-a,** ef.
**shprihem,** fint. shplodhem.
**shtata,** mb. i, e shtatë-a.
**shtrëngjis,** ft. shtrëngoj.
**shtunë-a,** ef. e shtunë.
**shul-i,** em. dru, ku mbështillet pëlhura në avlëmend.
**shum,** ndf. «për shum vjeç» (për shumë vjet, urim)

T.

**taban-i,** em. putra e këmbës.
**tartabit-i,** em. tartabiq.
**tashi,** ndf.
**tatar-i,** em. «tatarit kohë» (korrik).
**tate-ja,** ef. babai: «timja tate, taten s'e kam kutu, tontë tatëra».
**tavan-i,** em. Shm. «tavane».
**tavë-a,** ef. tepsia.
**t'e,** pv. ta: «t'e hajë».
**te,** pf. «zoktë van te lisi».
**teneqexhi-u,** em.
**tenxherè-ja,** ef.
**tepërzë,** ndf. «punë tepërzë kemi».
**të,** pd. «të nglat» (të ngjet).
**tëmbëlë-a,** ef. ëmbëlsirë. Shm. «tëmbëla».
**tënte-ja,** ef. e enjte.
**tëpërton,** ft. depërton.
**tërkuzë-a,** ef. litar.
**tim,** mb. «tim veshë» (veshi im), «time qafë» (qafa ime), «timja babo» (gjyshja ime), «timja djado» ose «toni djado» (gjyshi ynë), «tontë bota» (njerzit tanë, — gjindja jonë), «tontë kushërin» (kushërinjtë tanë).
**timtë,** mb. i, e imtë: «timtë koqe ishtë» (është kokër e vogël).
**tju,** pv. ty: «tju të desh».
**toçkërë,** mb. i, e vogël: «toçkërë çupa ishtë (çupa është e vogël); «toçkëra, moçkëra, gjisë kushtu vishenim» (të vegjël, të mëdhenj, të gjithë kështu vishemi).
**toçkërë-i,** em. toçkërat ritenë, neve mplakemi» (të vegjëlit rriten, ne plakemi).
**toftë,** ndf. «bën toftë» (ftohtë).
**toglë-i,** em, «togli djalë» (i vogli), «togli muoj» (shkurti).
**tohunxhi-u,** em. mjeshtër i punimit të mëndafshit. Edhe: **grën'jore.**
**tokë-a,** ef. 1) kambana; 2) tokàja e kishës.
**tokllù-i,** em. sheleg.
**tradafil-i,** em.
**trashëgohem,** fint. «trashëgohen» (urim: të trashëgohen), «të gëzohenë, të mplakenë, të trashëgohenë» (urim dasme).
**treta,** mb. i,e treta: «treta kushëri». Edhe: **tria.**
**trëshërë-a,** ef.
**tria,** mb. i, e treta: «tria kushëri»; «trinë» (të tretin).
**triot-i,** em. lojë dame, me tre ose nëntë gurë.
**trizet,** num. tridhjetë.
**turturushkë-a,** ef. turtull.
**tyfek-u,** em. «dju tyfekë». Edhe «tjufek».
**tymitur,** mb. i, e tymosur: «janë tymitura ca dru».
**tytyn-i,** em. duhan. Zakonisht: «tjutjun».
**tyxharllëk-u,** em. tregëti.

U.

**u!,** psth. «u! nuk ngopesh».
**u,** pjesëz e foljes pësore: «u nglinmë» (u ngimë).
**uçe-ja,** ef. daja: «timja uçe, tontë uçera»: dhe: «iku uçija».
**ugjale-t,** ef. shm. kalca, tirq.
**ujë-a,** ef. «cingë ujë dua», «ujës kupë» (kupë e ujit).
**ulk-u,** em. «ulku t'e hajë!»
**un,** pv. Më rrallë: «unë».
**uris-zi,** em. oriz.
**urof-vi,** em.
**urtohem,** fint. më merr uria. E pakryer: «unë urtohen'ja, urtohen'je urtohenish, urtohenim, urtohenishtë, urtohenishnë». E kryer: «u urtosha, u urtoshe, u urtua, u urtuam, u urtuat, u urtuan». E kry. tejka. «u kisha urtuar, u kishe urtuar» etj. E ardh. «o t'urtohem» etj. Lidh. «të urtohem» etj
**uzë-a,** ef. udhë.

V.

**val-i**, em. vaj.
**valle-ja**, ef.
**vapë-a**
**vargjel-i**, em. varangjel. lojë dame.
**vdes**, fint. «ajo të vdesë», «ka vdesur».
**verdë**, mb. i, e verdhë: «verda bojë».
**verem-i**, em. «veremit sëmundë» (tuberkulozi).
**verë-a**, ef. «verës kohë» (vera).
**verë-a**, ef. «verës kupë» (kupë e verës).
**veri-u**, em. vërri (lloj druri).
**vesë-a**, ef.
**veshë-i** em. «tim veshë» (veshi im).
**vete**, fint. «zoktë van te lisi»; «venish kontra» (shkonin kundër njëri-tjetrit).
**vetë**, pr. «vetë heqimet më kanë sënë».
**vetullë-a**, ef.
**vëlla-i**, em. «timja vëlla, timet vëllazëra».
**vëllamë-i**, em. «timja vëllamë, tontë vëllamëra». Persona që shërben për në martesë, jo probatini.
**vërtet**, ndf. «vërtet-li?» (vërtet?).
**viçe-ja**, ef. viç.
**viçko-ua**, em. viç i vogël.
**Viskuth-i**, em. edhe: **Bithkuq.**
**vit-i**, em. «ka katër vjeç, pes» (ka katër, pesë vjet), «për shum vjeç» (për shumë vjet, — urim).
**vjen**, fint. vi. E tashme: «unë vjen, vish, vjen, vijmë, vini, vijnë». E kryer: «jerça, jerçe, jerz ose erz, jermë, jertë, jernë».
**vreshtë-a**, ef.

X.

**Xallahin**, ft. flas. Edhe: **zallahin.** E tashme: «unë xallahin, xallahish, xallahin, xallahijmë, xallahini, xallahijnë». E pakryer: «xallahin'ja, xallahin'je, xallahinish, xallahishmë, xallahinishtë, xallahininë».
**xbirem**, fint. zhdukem. Edhe: **zbirem.** «U xbuar floria».

Xh.

**xhako-ua**, em. xhaxha, burrë i shkuar: «timja xhako, iku xhakua, tontë xhakora»; edhe: «ato xhakolat qeshën».
**xham-i**, em. «dju xhame».
**xhamadan-i**, em.
**xhurap-i**, em. çorape: «dju xhurape«.

Z.

**zallahin**, ft. dhe: **xallahin.**
**zbardhem**, fint. «m'u zbardhnë mustaqet».
**zbirem**, fint. dhe: **xbirem.** «Po zbiret gluha»; «u zbuor».
**zborë-a**, ef. «bije zborë».
**ze**, ldh. dhe.
**ze-a**, ef. dheu.
**zembelak-u**, em. zekthi.
**zesëtundurë-a**, ef. tërmeti: «dju zesëtundura«.
**zezë**, mb. i e zezë.
**zë-ja**, ef. zëri.
**zën**, ft. zë. E tashme: «unë zën, zësh, zën, zëjmë, zëni, zëjnë». E pakryer: «zën'ja, zën'je, zënish, zënimë, zënishtë, zëninë».

**zëmërherë-a,** ef. mesdita, dreka: «zëmërherë o t'hamë bukë», «hëngrëmë zëmërherë bukë».
**zëmp,** fint. dhëmb.
**zëmp-i,** em. dhëmb.
**zëmbórë-a,** ef. dhimbje: «kruves zëmbórë» (e dhëmbur e kokës), «barkot zëmbórë».
**zëndër-i,** em. dhëndërr.
**zgjezë-a,** ef. zgjedha e parmendës.
**zi-a,** ef. dhi.
**zinxhir-i,** em. «dju zinxhirë».
**zjar-i,** em.
**zok-gu,** em. «zoktë» (zoqtë).
**zoçkëzë-a,** ef. zogu i vogël i pulës.
**Zot-i,** em. Perëndia: «ndile, Zot» (ndje).

Zh.

**zhabë-a,** ef. bretkosë.
**zhellvë-a,** ef. breshkë.

Y.

**Yl-i,** em. yll: «dju yle».